

VENDIM
Nr.727, datë 30.10.2003

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.134, DATË 7.3.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR VËRTETIMIN DHE LEGALIZIMIN E DOKUMENTEVE TË
LËSHUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PËR PËRDORIM JASHTË VENDIT DHE
DOKUMENTEVE TË HUAJA PËR PËRDORIM BRENDË VENDIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.8372, datë 9.7.1998 "Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike apo konsullore", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Shtetit për Integrim European, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.134, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 2 shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje:

"2.1. Nëpunësit konsullorë të përfaqësisë së Republikës të Shqipërisë, të akredituar në Greqi, të legalizojnë, deri më 30 dhjetor 2003 dokumentet e lëshuara për përdorim jashtë vendit, pa i vërtetuar sipas pikës 1 të këtij vendimi."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano